



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

**BASHKIA DURRËS  
DREJTORIA E SHËRBIMIT SOCIAL**

**BASHKIA DURRËS SHPALL:**

**THIRRJE PUBLIKE PËR ORGANIZATAT E SHOQËRISË CIVILE PËR DORËZIMIN  
E OFERTAVE NË REALIZM TË SHËRBIMIT “SHËRBIM PSIKOLOGJIK, LIGJOR  
DHE LINJA TELEFONIKE, PËR VIKTIMAT E DHUNËS NË FAMILJE”**

Bashkia Durrës përmes thirrjes “Shërbim psikologjik, ligjor dhe linja telefonike, për viktimat e dhunës”, të financuar nga buxheti lokal, ka për qëllim zvogëlimin e të gjitha formave të praktikave të dëmshme, dhunës me bazë gjinore dhe dhunës në familje, ofrimit të shërbimeve mbështetëse të specializuara për viktimat.

Qëllimi i veçantë i Bashkisë Durrës është fuqizimi i bashkëpunimit ndërmjet Bashkisë Durrës dhe shoqërisë civile lidhur me financimin e organizatave të shoqërisë civile (OSHC) edhe me buxhet të pushtetit lokal në përputhje me prioritetet lokale.

Bashkia Durrës raporton një praktikë të mirë në funksionimin e mekanizmit lokal për parandalimin e dhunës. Në 2019 është rifirmosur marrëveshja mes Bashkisë dhe institucioneve që në përputhje me ligjin duhet të jenë pjesë e mekanizmit lokal.

Bashkia ka një plan të aprovuar për barazinë gjinore në bashki për periudhën 2023-2025, i përgatitur nga Bashkia në kuadër të zbatimit të Kartës Evropiane për Barazi Gjinore të grave dhe burrave në jetën vendore. Bashkia shprehet e angazhuar që të vijojë me ndërmarrjen e veprimeve për përmbushjen e objektivave të planit social 2021-2024. Objektivi specifik 3.7 i këtij plani ka si qëllim rritjen e efektivitetit të qasjes shumë-sektoriale dhe shërbimeve bazë të specializuara për viktimat/të mbjetuarit/at e dhunës me bazë gjinore.

Struktura e bashkisë lidhur me shërbimet për dhunën përbëhet nga dy specialiste (koordinatore të dhunës në familje), të cilat mbështeten nga specialistja për barazinë gjinore. Stafi i bashkisë raporton një rritje të numrit të rasteve që raportojnë dhunën, si rrjedhojë e rritjes së ndërgjegjësimit në këtë drejtim. Pandemia dhe katastrofa e natyrore e tërmetit 11/19 gjithashtu ndikuan në rritjen e numrit të rasteve, sic u raportua nga punonjësit e policisë dhe stafi i bashkisë, teksa gratë dhe fëmijët ishin të izoluar në të njëjtën shtëpi me dhunuesin, dhe kishin vështirësi në aksesimin e shërbimit të policisë

dhe këshillimit online. Përsa i përket identifikimit të rasteve, punonjësit raportojnë sfida në këtë drejtim, në bashkëpunimin me aktorët e tjerë. Nuk ka raportime nga administratorët shoqërorë dhe as nga sektori i shëndetësisë.

Duke vlerësuar:

- sfidat e identifikuar, në kuadrin e përmirësimit të shërbimeve të ofruara për viktimat e dhunës dhe numrin e ulët të stafit të bashkisë në këtë drejtim, shoqëruar me mungesën e mjeteve të transportit për ta;
- nga ana tjetër, vështirësitë e grave të dhunuara për raportim, largësinë nga shërbimet për një numër të konsiderueshëm të rasteve, për të cilat nuk ofrohet mbulimi i shpenzimeve të transportit, nevojat për shërbime të specializuara psikologjike dhe ligjore për manaxhimin e situatave të dhunës për gratë dhe fëmijët e tyre.

Bashkia Durrës do të vijojë praktikat pozitive të asistimit të rasteve përmes shërbimeve për të mbijetuarit e DHF/DHBGJ, përmes bashkëpunimit dhe partneritetit me organizatat e shoqërisë civile kompetente dhe të specializuara në këtë fushë. Shërbimet e planifikuara synojnë gjithashtu të përmirësojnë ndjeshëm jo vetëm punën e Bashkisë, por edhe efektivitetin e funksionimit të Mekanizmit të Koordinuar të Referimit të rasteve të dhunës në familje. Të gjitha rastet e dhunës në familje që do të paraqiten pranë institucioneve anëtare të Mekanizmit të Koordinuar të Referimit në Durrës do të menaxhohen me sukses duke iu mundësuar shërbimet ligjore e psikologjike, në bashkëpunim dhe partneritet me OJF-në e specializuar.

Mbështetja do të ofrohet për gratë dhe vajzat viktime të dhunës në familje dhe DHBGJ, që vijnë nga grupe të cënueshme e që pësojnë diskriminim të shumëfishtë si: gra, të reja dhe vajza nga zonat rurale, nga minoritetet etnike, me aftësi të kufizuara, LGBTI+, nëna të vetme, të dhunuara, të trafikuar, të moshuara, emigrante, azilkërkuese, etj., pra nga të gjithë grupet në shoqëri si dhe fëmijët e tyre.

Bashkia ka dedikuar burimet financiare të nevojshme në buxhetin 2023 për zbatimin e marrëveshjes së planifikuar të lidhet me organizatën shërbimofruese pas përfundimit të procesit të vlerësimit në dobi të zbatimit më të mirë të legjislacionit e politikave për barazinë gjinore e kundër dhunës në familje si edhe për ofrimin e shërbimeve të nevojshme për viktimat / të mbijetuarat e dhunës me bazë gjinore.

Bashkia Durrës fton të gjitha Organizatat e Shoqërisë Civile (OSHC-të) që të paraqesin ofertat e tyre në përputhje me qëllimin e shërbimit dhe aktiviteteve të tij.

**Shuma e fondit për shërbimin e miratuar në total do të jetë 2'700'000 lekë (TVSH e përfshirë) në vit.**

**Fondi i alokuar në kuadrin e kësaj thirrjeje publike do të financojë shpenzimet për shërbimin psikologjik, ligjor si dhe kostot e linjës telefonike.**

**Bashkia rezervon të drejtën të mos i alokojë të gjitha fondet që ka në dispozicion në rast se propozimet e paraqitura nuk i plotësojnë kriteret e përcaktuara.**

**Kohëzgjatja e shërbimit është 36 muaj, përmes kontratave të rinovueshme 1 vjeçare.**

#### **PËRSHTATSHMËRIA/PRANUESHMËRIA:**

Pjesëmarrja në këtë thirrje publike është e hapur, në baza të barabarta, për të gjitha OShC-të e regjistruara zyrtarisht (shoqata/organizata apo fondacion) në përputhje me ligjet dhe rregulloret e në fuqi në Shqipëri dhe kriteret e thirrjes. **Të gjitha organizatat e shoqërisë civile të interesuara mund të gjejnë informata të hollësishme rreth kushteve për aplikim si dhe për kriteret për financimin e propozimeve në Udhëzimin për Aplikant, që është pjesë përbërëse e dokumentacionit të thirrjes publike.**

#### **DOKUMENTACIONI:**

Dokumentacioni i aplikimit për thirrjen publike të **Bashkisë Durrës** do të jetë i disponueshëm nga data **25.10.2024**.

Të gjitha informatat e nevojshme, si dhe një version elektronik i paketës së aplikimit mund të gjendet edhe në Web-faqen zyrtare të Bashkisë (<http://www.durres.gov.al>).

#### **DORËZIMI I APLIKIMEVE:**

Aplikimet e plotësuara (me të gjithë dokumentet mbështetëse) duhet të dorëzohen **në tri (3) kopje të shtypura dhe një kopje elektronike (CD apo USB)**, të vendosura në një zarf të vulosur mbi të cilin është shkruar referenca e thirrjes publike, përmes postës zyrtare apo personalisht, gjatë ditëve të punës (e hënë – e premte), nga ora 08:00 deri ora 16:00, në adresën në vijim:

***Bashkia Durrës, Sheshi “Liria”, Kodi Postar 2001, Durrës, Shqipëri***

**Afati për dorëzimin e aplikimeve është data 11.11.2024.** Aplikimet e dorëzuara pas këtij afati do të merren parasysh vetëm nëse vula postare tregon se data dhe koha e dërgimit ka qenë para mbylljes së afatit zyrtar. Pjesa e jashtme e zarfit duhet të përmbajë titullin e thirrjes për dorëzimin e ofertave, emrin dhe adresën e plotë të kandidatit, **“Të mos hapet përpara hapjes zyrtare.”** Të gjithë aplikantët që kanë paraqitur propozime financiare, pavarësisht nëse pranohen ose jo, njoftohen me shkrim për vendimin e marrë për propozimin e tyre brenda 10 ditësh nga mbyllja e thirrjes publike.